



Aplikimi për bursa në Penda (udhëzues hap pas hapi)

3 shtator 2022

Objektivat e Prezantimit

Penda – organizata

Ka ndarë më shumë se 50 bursa brenda katër viteve akademike.

Përse është me rëndësi ky takim?

Për këto katër vite komisioni vlerësues i Pendës ka marrë qindra aplikacione dhe ka vërejtur gabime të zakonshme dhe të përsëritura në dokumentet e aplikimit.

Qëllimi i këtij prezantimi është të ofrojë informacione të cilat mund të ndihmojnë konkurruesit për shkollim, punësim dhe në veçanti për bursa tek Penda në mënyrë që të rriten mundësitë e tyre për sukses.

Rendi i ditës

- ❖ 10:00 - 10:15 Hyrje
- ❖ 10:15 – 10:30 CV
- ❖ 10:30 – 10:45 Letra e motivimit
- ❖ 11:00 – 11:15 Pauzë
- ❖ 11:15 – 11:30 Letra e referencës
- ❖ 11:30 – 11:45 Intervista
- ❖ 11:45 – 12:00 Pyetje dhe përgjigje

Përmbledhje lidhur me procesin e përzgjedhjes

Fazat e procesit

Faza e parë: Shpallja për aplikime

Faza e dytë: Skanimi i dokumenteve të aplikimit dhe përgatitja e listës së ngushtë

Faza e tretë: Intervistat

Faza e katërt: Diskutime dhe vendimmarrja për fituesit

Çfarë kërkon komisioni vlerësues?

- ❖ A ka studenti/ja kualifikimin dhe cilësitë e nevojshme për bursë?
- ❖ A është studenti/ja i ndërgjegjshëm, punëtor dhe nuk ka gjasa të braktisjes?
- ❖ A kanë me të vërtetë interesim në fushat e tyre të studimit dhe dëshirën për të mësuar më shumë?
- ❖ Si duken aftësitë e tyre të komunikimit?

Përgatitja e pakos suaj të aplikimit

Lista e dokumenteve të nevojshme:

- ❖ Formulari i aplikimit
- ❖ CV
- ❖ Letra e motivimit
- ❖ Dy letra të referencës
- ❖ Transkriptat (Certifikata e notave)
- ❖ Vërtetim për punësim dhe të ardhurat e prindërve të kandidat-es/it

Shuma e shpërblyer

5,000 denarë të Maqedonisë në muaj (për periudhën prej 9 muajsh akademik)

Datat

Shpallja për bursa: 15 korrik 2022

Afati : 16 shtator 2022

Vetëm aplikacionet e plota të dorëzuara brenda afatit kohor do të shqyrtohen!!!

CV (Curriculum Vitae - Jetëshkrimi)

Çka është CV-ja? Pse është me rëndësi?

CV-ja është përmbledhje e shkurtër e arsimimit, historikut të punësimit, shpërblimeve dhe arritjeve.

CV-ja juaj është një vegël për t'ju njoftuar juve me lexuesin dhe ju ndihmon të kaloni nga faza e aplikimit në intervistë.

Me rëndësi është që CV-ja juaj të përgatitet mirë në një format të qartë, gjë që e bën të lehtë të lexohet dhe të gjenden informacionet relevante dhe të duhura.

Thjeshtësia është gjithmonë më e mira!

Si të bëni Formatin e CV-së suaj?

Dokumenti duhet të organizohet në mënyrë kronologjike dhe duhet të jetë sa më e lehtë të merret një përmbledhje e arsimimit dhe karrierës së punësimit të individit.

CV me formatin e duhur përfshin:

- ❖ Të dhënat personale dhe të kontaktit
- ❖ Arsimimin
- ❖ Përvojën e punës
- ❖ Aftësitë
- ❖ Interesat

Të dhënat personale dhe kontakti

Sigurohuni që ky seksion të paraqesë qartë të dhënat tuaja si vijon:

- ❖ Emri
- ❖ Adresa e banimit
- ❖ Numri i telefonit
- ❖ Adresa e e-mailit
- ❖ Data e lindjes (opsionale, por ndihmon)
- ❖ Fotografi (opsionale)
- ❖ Përfshini adresën tuaj URL për Linked-in

Të dhënat personale dhe kontakti

Shembull



Emri: Kaltrina Rexhepi

Data e lindjes: 13/02/2001

Adresa: Ilindenska #63, 1200 Tetovë, Maqedonia e Veriut

Email: Kaltrina.Rexhepi@gmail.com

Telefoni: +38970136333

LinkedIn: www.linkedin.com/in

Arsimimi

Në një rend kronologjik paraqitni listën e diplomave që keni fituar apo janë në vazhdim e sipër, institucionet dhe vitet e diplomimit.

Formati:

- ❖ Diploma
- ❖ Muaji/viti i marrjes së diplomës apo kur pritet
- ❖ Institucioni
- ❖ Fusha e studimit

Një përmbledhje e shkurtër e kurseve të rëndësishme që keni vijuar mund të jetë e dobishme po ashtu.

Arsimimi - Shembull

M.A. Në ekonomi

2003–2005

Universiteti i Evropës Juglindore

Ekonomia e Financave Publike

Bachelor në Administrim Biznesi

2001–2003

Universiteti Shtetëror i Tetovës

Administrim Biznesi

Përvoja e punës

Në një radhë kronologjike paraqitni emrat e punëdhënësve tuaj (kompanive/organizatave), pozitën e punës, vendin, datat e punësimit dhe sigurisht detyrat tuaja.

Sigurohuni të përfshini praktikën në punë dhe pozitat e papaguara nëse janë relevante.

Përvoja si vullnetar mund të listohet nëse është e përshtatshme këtu.

Formati:

- ❖ Pozita e punës
- ❖ Punëdhënësi
- ❖ Datat (fillimi-fundi)
- ❖ Vendi
- ❖ Përgjegjësitë

Përvoja e punës – Shembull

Praktikant

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP Shkup)

[01/04/2019 – 31/05/2019]

Qyteti: Shkup

Përgjegjësitë: Organizimi dhe azhurnimi i orareve në departamentin e burimeve njerëzore

Aftësitë

Aftësitë mund të ndahen në dy kategori:

1. Aftësi të buta - aftësi që mund të zbatohen në të gjitha profesionet. Këto përfshijnë të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, të folurit publik, shkrimin profesional, punën ekipore etj.
2. Aftësitë e forta – aftësitë të cilat mund të mësohen, aftësitë apo shkathtësitë që mund të maten me lehtësi. Këto përfshijnë aftësitë teknike, aftësitë kompjuterike, aftësitë analitike etj.

Shembull për aftësitë

NJOHJA E GJUHËVE:

Gjuha(ët) amtare: Shqip

Gjuhë tjetër/tjera:

Anglisht (rrjedhshëm)

Maqedonisht (rrjedhshëm)

Turqisht (Niveli i mesëm)

Gjermanisht (Njohuri bazike)

AFTËSI TË TJERA:

Aftësi për organizim dhe planifikim / dëgjues dhe komunikues i mirë / i orientuar në hollësi / menaxhim i mirë i kohës / aftësi të shkëlqyera në komunikimin me shkrim dhe gojor

Interesat

Komisioni vlerësues shpesh shikon hobit dhe interesat që përfshihen në CV-të e personave pasi që një gjë e tillë jep një përmbledhje të përgjithshme lidhur me kandidatin dhe po ashtu mund të japë ide tejet të rëndësishme lidhur me personalitetin dhe motivimin. Kështu ndodh shpesh nëse kandidati është student me më pak përvojë pune.

Këto janë veçanërisht relevante nëse keni qenë të përfshirë në aktivitete në të cilat keni pasur përgjegjësi udhëheqjeje apo keni pasur të bëni me të tjerët në një ekip.

Të jini të saktë, p.sh. Leximi (çka saktësisht? P.sh. Romanet e shekullit XIX), Sporti (cilat sporte? P.sh. Tenisi apo futbolli).

Interesat - Shembull

- ❖ *Leximi i romaneve të shekullit XIX*
- ❖ *Kapiten në ekipin e futbollit të shkollës së mesme*
- ❖ *Kampion i shahut në qytet për 2021*
- ❖ *Këngëtar kryesor i bendit "..."*
- ❖ *Redaktues i librit vjetor, klasa e ... '21*
- ❖ *Etj.*

Këshilla të dobishme

- ❖ Gjithmonë kontrolloni CV-në tuaj për gabime në shkrim, nuk ka vend për gabime gramatikore e shkrimi!
- ❖ Mos përfshini: gjatësinë tuaj trupore, peshën, vendlindjen, gjendjen martesore, etninë/racën, shëndetin
- ❖ Përdorni një font apo format shkronjash që lexohen lehtë
- ❖ Madhësia e shkronjave duhet të jetë ndërmjet 10 dhe 12 pt
- ❖ E ruani dokumentin e CV-së në formatin PDF
- ❖ Thoni vetëm të vërtetën!

Platformat për ndërtimin e CV-së

Dy prej platformave që më së shpeshti përdoren për krijimin e CV-së janë:

- ❖ Europass – Si shabllon i krijuar nga Komisioni Evropian

Linku: <https://europa.eu/europass/en>

- ❖ LinkedIn – E ruani një profil në PDF (LinkedIn ➡ View Profile ➡ More ➡ Save as PDF)

Linku: <https://www.linkedin.com/feed/>

Letra e motivimit

Çka është një letër motivimi?

Një letër motivimi është një ese e tëra lidhur me ju dhe interesat tuaja në fushën e zgjedhjes suaj, se cilat janë aftësitë dhe përvojat tuaja të krijuara në atë fushë dhe cilat janë synimet dhe planet tuaja për të ardhmen.

Pyetjet të cilave duhet t'ju përgjigjeni në një letër motivimi:

1. Kush jeni ju?
2. Çka ka pasur ndikim tek rruga e karrierës suaj deri më tani?
3. Interesat tuaja profesionale
4. Ku planifikoni të arrini prej këtu?

Qëllimet e letrës së motivimit

Një letër motivuese duhet të reflektojë cilësitë në vijim:

- ❖ Motivimin për të hyrë/vazhduar në një fushë të caktuar
- ❖ Potencialin intelektual
- ❖ Cilësitë e lidërshiptit
- ❖ Dashurinë për të mësuar
- ❖ Forcën e karakterit
- ❖ Aftësitë apo talentet e veçanta
- ❖ Arritjet
- ❖ Zellin dhe përkushtimin
- ❖ Integritetin dhe sinqeritetin
- ❖ Mirëkuptimin

Anatomia e letrës së motivimit

Ndani në paragrafë:

Paragrafi 1: Hyrje në temë, aspektet në të cilat jeni të interesuar dhe pse

Paragrafi 2: Çka keni bërë lidhur me temën e që nuk është përfshirë tashmë në aplikacionin tuaj

Paragrafi 3-4: Përvoja e punës dhe aktivitetet relevante në shkollë

Paragrafi 5: Interesat tuaja jashtë shkollës, veçanërisht ato që tregojnë se jeni i përgjegjshëm dhe person i besueshëm

Paragrafi 6: Qëllimi i juaj i vijimit të universitetit/marrjes së bursës dhe një koment që kujtohet lehtë

Një shembull i letrës së motivimit

Kujt mund t'i interesojë,

Quhem Jeton Bajrami dhe jam student i vitit të tretë në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Aktualisht jam në vijim të studimeve në programin Baçelor pesëvjeçar, dhe planifikoj të vazhdoj në programin njëvjeçar master pas diplomimit.

Gjatë kohës sa kam qenë në shkollë të mesme kam punuar me degën lokale të degës së Habitat for Humanity për të ndihmuar në ndërtimin e shtëpive për familjet me të ardhura të ulëta. Kam mësuar lidhur me procesin e ndërtimit prej themelit e tutje, dhe kam zbuluar rëndësinë e funksionit në projektimin arkitektonik. Shtëpitë që kemi ndërtuar gjatë periudhës katër vjeçare sa isha vullnetar nuk ishin asnjëherë ekstravagante, por ato i kanë shërbyer qëllimit dhe u bënë dritë shprese për pronarët e tyre.

Shkollimi im kryesisht është fokusuar në këtë mentalitet: funksioni para formës, stabiliteti para dukjes. Jam regjistruar në disa ligjërata që shkojnë përtej Inxhinierisë Arkitekturore si fushë kryesore për shkak se dua të kem një pikëpamje gjithëpërfshirëse të asaj se si dizajni takohet me strukturën. Kam punuar në projekte të dizajnit të banimit për kredi shtesë nën mbikëqyrjen e profesorëve të mi të arkitekturës (Dr. X dhe Dr. Y) për të përshpejtuar punën time kërkimore dhe arsimimin tim.

Dëshira ime ka qenë të bëhem arkitekt për të krijuar mundësi të qasshme e të përballueshme strehimi në komunitetet me kushte të pafavorshme. Derisa kam jetuar në qytetin universitar kam parë prona të panumërta që lëshohen me qira, por ka edhe disa shtëpi për shitje që janë të përballueshme për studentët e kolegjit dhe blerësit për herë të parë. Kështu është gjendja në shumë qytete në tërë Maqedoninë e Veriut, veçanërisht zonat me standard të ulët jetese. Qëllimi im është të ndërtoj lagje të përshtatshme për fillestarët që të mund të ndihmojnë të rriturit të ndërtojnë kapital dhe të shmangin borxhin e tepërt si dhe të arrijnë qëndrueshmëri financiare për të ardhmen e tyre.

Kam planifikuar një praktikë pune në firmën arkitekturore LMNOP gjatë verës, dhe do të vazhdoj trajnimin në vendin e punës edhe pas diplomimit në master. Pas punës me arkitektë të njohur rezidencial do të dëshiroja të hapë firmën time arkitekturore me fokus në zhvillimin e shtëpive të lira por me cilësi të lartë. Po ashtu do të doja të punoj sërish me Habitat for Humanity, kësaj here si arkitekt e jo më si punëtor fizik. Besoj fuqimisht në misionin e tyre për ndërtimin e "një bote ku secili ka një vend të dinjitetshëm për të jetuar."

E çmoj vlerësimin tuaj. Me ndihmën tuaj mund të vazhdoj shkollimin në arkitekturë dhe projektim për të mundësuar shtëpi të qasshme për ata që kanë nevojë.

Sinqerisht,

Arsyet se pse një letër motivimi mund të refuzohet

- ❖ Shkrimi dhe gramatika e dobët.
- ❖ Përfshirja e përmbajtjes që nuk është relevante.
- ❖ Plagjiatura nga letrat e motivimit nga burimet e hapura.
- ❖ Fokusimi i tepërt në çështje negative e jo në shtjellimin e aspekteve pozitive dhe potencialeve.
- ❖ Bërja e deklarimeve ofenduese.

Letër referenca/rekomandimi



Çka është një letër reference? Përse është e rëndësishme?

Një “Letër Reference” përmban një vlerësim të përgjithshëm të cilësive, interesave, qëndrimeve, integritetit, përfshirjes në komunitet dhe karakteristikat personale të një personi.

Letrat e referencës po ashtu përdoret për të vlerësuar karakterin e individit dhe konfirmon hollësitë lidhur me situatën e individit apo rrethanat.

Letër referencat efektive mund të kenë peshën e pranimit apo refuzimit të një kandidati.

Kujt duhet t'i kërkonte letër reference?

Letër reference iu kërkonte personave që ju njohin juve dhe aftësitë tuaja, siç janë mësimdhënësit, ish punëdhënësit, trajnerët, miqtë me ndikim të cilët ju njohin për një kohë të gjatë.

Të afërmit nuk janë zgjedhje e mirë.

Zakonisht mjaftojnë dy letra.

Si duhet t'ju kërkonti atyre?

- ❖ U jepni kohë të mjaftueshme personave që u kërkonti të shkruajnë letrën e referencës për ju — një javë deri 10 ditë duhet të jenë të mjaftueshme.
- ❖ U tregoni atyre për qëllimet tuaja dhe çka do të mund të shkruajnë që do t'ju ndihmonte të arrini qëllimet tuaja.
- ❖ Nëse nuk e merrni letrën e referencës brenda 10 ditësh nga biseda me shkruesit e mundshëm, ndoshta do të ishte mirë të kontaktoni ata për të konfirmuar se secili është në dijeni për afatet tuaja kohore.
- ❖ Sapo të keni marrë letrat tuaja të referencës, u ktheni letër falënderimi shkruesve. Po ashtu duhet të njoftoni secilin prej shkruesve lidhur me suksesin dhe se sa ju kanë ndihmuar letër referencat e tyre për arritjen e qëllimit tuaj.
- ❖ Këshillë shtesë: Edhe nëse ata mund t'ju kërkojnë ta shkruani vet, mos e bëni këtë!

Shembulli i një letre reference

Të nderuar komision vlerësues i Pendës,

Kam kënaqësinë të rekomandoj Gentiana Hoxhën për bursë tek Penda.

E njoh zonjushën Hoxha për tri vite tashmë si studente ne Universitetin e Evropës Juglindore. Si profesor i saj, kam pasur mundësinë të vëzhgoj pjesëmarrjen dhe ndërveprimet e saj në ligjërata si dhe të vlerësoj njohuritë e saj lidhur me lëndën. Ajo është studente e dalluar në të gjitha aspektet. Gentiana ka dëshmuar se përmes punës së palodhshme, përcjelljes dhe punës ekipore ajo mund të realizojë detyrat me mirësjellje dhe brenda afateve kohore.

Zonjusha Hoxha është e pajisur mirë për tu zhvilluar nga sfidat me të cilat ajo përballlet. E rekomandoj fuqimisht Gentiana Hoxhën për bursën nga Penda. Nëse keni ndonjë pyetje shtesë lidhur me të, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni në numrin 070 523 784.

Sinqerisht,

Intervista

Çka është një intervistë? Pse është e rëndësishme?

Një intervistë është mundësia juaj për të treguar personalitetin tuaj dhe për t'i treguar komisionit të vlerësimit gjërat që nuk kanë mundur t'i gjejnë në aplikacionin tuaj.

Lloji i intervistës që përdoret nga Penda

- ❖ Intervistë në panel (një kandidat – 4 deri 6 anëtarë të Pendës)
- ❖ Zakonisht rreth 15 minuta për kandidat
- ❖ Bazuar në një sistem pikësh të llogaritur në mesin e anëtarëve të pranishëm

Para intervistës

- ❖ Bëni hulumtimin tuaj
 - Lexoni këto slajde!
- ❖ Lexoni sërish aplikacionin tuaj
 - Përparësitë dhe dobësitë
 - Përse të nevojitet bursa?
- ❖ Hulumtoni për pyetjet që u janë bërë studentëve para jush.
- ❖ Flini mirë natën para intervistës që të jeni sa më vigjilent.

Gjatë intervistës

- ❖ Arrini 15 minuta më herët.
- ❖ Keni vetëbesim, përdorni kontaktin me sy, buzëqeshni!
- ❖ Mos bëni lëvizje të pakontrolluara. Jini i qetë. Mos rrini plogësht apo shtrembër.
- ❖ Fikni telefonin mobil.
- ❖ Jini i singertë.
- ❖ Flisni qartë. (Mos përtypni gomë përtypëse he mos pini duhan)
- ❖ Mendon para se të përgjigjeni në pyetje. Përgjigjuni me sinqeritet. Nëse nuk e dini, thoni se nuk e dini.
- ❖ Nëse nuk e kuptoni ndonjë pyetje, i kërkonti intervistuesit ta përsëris atë.
- ❖ Mbani mend se secila pyetje është një mundësi për ju që të tregoni veten. Tregoni ngjarje të shkurtra të cilat demonstrojnë suksesin tuaj.
- ❖ Jepni shembuj ku intervistuesit mund ta krijojnë përshtypjen se jeni i suksesshëm në atë që po përshkruani.
- ❖ Bëni pyetje të cilat nuk janë cekur në intervistë tashmë.
- ❖ Bëni maksimumin; mos u përpiqni të tejkaloni mundësitë tuaja.

Pyetjet e mundshme

1. Na tregoni për veten tuaj.
2. Ku e shihni veten pas dhjetë vitesh?
3. Pse e keni zgjedhur këtë fushë specifike studimi?
4. Pse mendoni se jeni kandidat i mirë për këtë bursë?
5. Cila është arritja juaj më e madhe?
6. Etj.

Këshillat për intervistë

Vishuni

- ❖ Në mënyrën e duhur

Çfarë duhet marrë?

- ❖ Dokumentet e kërkuara (nëse është e nevojshme)

Arrini me kohë

- ❖ Planifikoni rrugën tuaj
- ❖ Rezervoni ca kohë shtesë për udhëtim në rast se dalin probleme

Takimi me intervistuesit

- ❖ Jini i relaksuar, por mbani mend se jeni nën vëzhgim për gjuhën tuaj trupore
- ❖ Ndryshoni tonin e zërit tuaj – Buzëqeshni!

Pyetje dhe Përgjigje

Ju lutem mos ngurroni të bëni ndonjë pyetje ose të shprehni ndonjë shqetësim.



Ju faleminderit për
vëmendjen dhe ju
urojme fat!